



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. "Agim Ramadani" nr. 23, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: ++381 38 500 400, Faks: ++ 381 38 248 076, E-mail: info@pak-ks.org, ueb: ëëë.pak-ks.org

AMANDAMENTET
E RREGULLORES PËR SHITJEN E ASETEVE TË CAKTUARA TË NDËRMARRJEVE
SHOQËRORE ME NEGOCIM DIREKT

Neni 1

Neni 3 paragrafi 3.1 [b] riformulohet me paragrafin si në vijim:

3.1.b1 Ndërtimet e realizuara, të cilat nuk janë të dukshme në incizimet deri më datën 31 dhjetor 2018, kur në Territorin e Republikës së Kosovës është zbatuar incizimi i fundit aerofotogrametrik nuk do të përfshihen në proces të negocimit.

Neni 2

Neni 15.2 plotësohet me nënkategorinë në vijim:

- Raporti i zyrtarit në terren:

Neni 3

Neni 16 plotësohet me paragrafët si në vijim:

16.3. Për kërkesat e regjistruara deri me 29 Janar 2020 në ato raste kur Agjencia Kosovare e Privatizimit vendos për iniciimin e negocimit direkt, parashtruesi do ta paguaj shumën e mjeteve në lartësi prej 100.00 [njëqind euro] në emër të shpenzimeve administrative, kur në procesin e negocimit janë përfshirë ekonomitë familjare.

16. 4. Për kërkesat e regjistruara deri me 29 Janar 2020 në ato raste kur Agjencia Kosovare e Privatizimit vendos për iniciimin e negocimit direkt, parashtruesi do ta paguaj shumën e mjeteve në lartësi prej 300.00 [treqind euro] në emër të shpenzimeve administrative, kur kërkesa e parashtruesit janë të natyrës afariste.

16. 5 Për të gjitha kërkesat e regjistruara pas datës 29 Janar 2020, shumat e përcaktuara për parashtruesit: ekonomitë familjare apo afariste sipas neneve 16.3 dhe 16.4 do të aplikohen me rastin e dorëzimit të kërkesës.

Neni 4

Neni 19.2 riformulohet si në vijim:

19.2. Kur kjo konsiderohet e nevojshme, secila nga palët [Agjencia ose parashtruesi] kanë të drejtë të kërkojnë super-ekspertizë, për arsyet e cituara si më sipër me të cilën përfundon procedura e vlerësimit. Kërkesat për super-ekspertizë do të nënshtrohen shqyrtimit paraprak nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 5

Plotësim ndryshimet me këtë Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Prishtinë, 29/01/2020

Bajram Zejnullahu



Kryesues

Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimi